

GJYKATA E QARKUT NE MITROVICE

P Nr. 01/2010

14 Tetor 2010

NE EMER TE POPULLIT

Gjyakata e Qarkut ne Mitrovice, ne Trupin Gjykues te përbëre nga Gjyqtarja e EULEX-it Judge Christine Lindemann-Proetel si Kryetare e Trupit Gjykues, Gjyqtareve te EULEX-it Caroline Charpentier dhe Nikolay Entchev si Anëtare te Trupit Gjykues, me pjesëmarrjen e Zyrtares Ligjore te EULEX-it Tara Khan si Procesmbajtëse ne Lenden Penale kundër:

Asllan PEÇI, i akuzuar sipas Aktakuzës PP. Nr. 128/08 te ngritur me 15 Korrik 2009 nga Prokurori Publik Shyqyri Sylja, dhe pjesërisht e miratuar nga Pala e Dëmtuar, Asllan Fazliu mbi tërheqjen e akuzës se Vrasjes nga Prokurori i EULEX-it Antonio Pastore me 14 Tetor 2010, me:

Akuza (1) - Vrasje, e definuar ne Nenin 146 te Kodit te Përkohshëm Penal te Kosovës (KPPK) dhe

Akuza (2) – Mbajtje ne Pronësi, ne Kontrolle, ne Posedim ose ne Shfrytëzim te Pa-autorizuar te Armeve e definuar ne Nenin 328 Paragrafi (2) i KPPK.

Pas mbajtjes se seancave publike te shqyrtimit kryesor te datës 12, 13, dhe 14 Tetor 2010, te gjitha ne prezence te te Akuzuarit Asllan Peci, Avokatit te tij Mbrojtës Mahmut Halimit, Prokurorit Publik te EULEX-it Antonio Pastore dhe Palës se Dëmtuar Asllan Fazliu;

Pas pleqnimit dhe votimit te Trupit Gjykues te mbajtur me 14 Tetor 2010, ne te njëjtën dite sipas Nenit 392 Paragrafi (1) i KPPK, shpalle publikisht dhe ne prezence te te Akuzuarit, Avokatit Mbrojtës, Prokurorit Publik dhe Palës se Dëmtuar me sa vijon.

AKTGJYKIMI

ASLLAN PECI, djali i Sahit Pecit dhe Halime Avdiut i lindur me 16 Korrik 1943 ne Fshatin Rahove, Komuna e Mitrovicës, Kosovar-Shqiptar, aktualisht me vendbanim ne Fshatin Rahove, ka kompletuar shkollën fillore, i Pensionuar dhe me te ardhura mesatare, i martuar, baba i tete fëmijëve, i padënuar;

SHPALLET FAJTOR

Akuza I) Sepse me 16 Dhjetor 2008 rreth orës 14:00 gjate një argumenti ndërmjet Asllan Pecit dhe Ramadan Fazliut ne lidhje me kullotjen e bagëtive, Ramadan Fazliu e ka sulmuar dhe goditur Asllan Pecin ne nofull me gërshëre bujqësore dhe Asllan Peci iu është përgjigjur duke shtënë katër here me AK-47, 7.62x39mm pushke automatike, numri serik C-97080, ne drejtim te Ramadan Fazliut dhe duke e qëlluar atë dy here ne dorën e majte dhe dy here ne këmben e majte dhe duke e privuar atë nga jeta. Edhe pse Asllan Peci ka shtënë nga arma e tij ne vetëmbrojtje nga një sulm i paligjshëm, real dhe eminent te Ramadan Fazliut, përgjigja e tij ka qene jo proporcionale ne krahasim me shkallen e rrezikut te shkaktuar nga sulmi, prandaj e ka tejkaluar nivelin e vetëmbrojtjes se domosdoshme.

Me një akt te tille, Asllan Peci ka kryer dhe është penalisht përgjegjës për veprën penale te Vrasjes siç definohet ne Nenin 146 te (K(P)PK)

Edhe pse Asllan Peci e ka kaluar nivelin e vetëmbrojtjes se domosdoshme, sepse ai e ka bere këtë për arsye te traumave te renda apo frikës nga sulmi, hiqet dore nga dënimi për veprën penale te Vrasjes sipas Nenit 8, Paragrafi (4) i K(P)PK.

Akuza II) – Sepse Asllan Peci ka qene ne posedim te armës – pushke automatike AK-47 te kalibrit 7.62x39mm me numër serik C-97080 – pa autorizim ligjor dhe e ka përdorur armen për te privuar Ramadan Fazliun nga jeta e tij.

Me një akt të tillë Asllan PEÇI ka kryer dhe penalisht është përgjegjës për veprën penale Mbajtje në Pronësi, në Kontrollë, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armeve në shkelje të Nenit 328 Paragrafi (2) të K(P)PK.

Prandaj Asllan PEÇI

DENOHET

Me dy vite burg për veprën penale Mbajtje në Pronësi, në Kontrollë, në Posedim ose në Shfrytëzim të Pa-autorizuar të Armeve.

Koha e kaluar në paraburgim nga 16 Dhjetor 2008 deri me 08 Shtator 2010 dhe pastaj nën Arrest Shtëpiak do të numërohet sipas Nenit 73, Paragrafi (1) i K(P)PK.

Në këtë mënyrë masa e Arrestit Shtëpiak kundër Asllan Pecit ndërpritet.

Arma – AK-47 e kalibrit automatik 7.62x39mm me numër serik C-97080 – konfiskohet sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328 Paragrafi (5) i K(P)PK.

I Akuzuari Asllan Peci do të kompensohet për shpenzimet e procedurës penale sipas Nenit 102 Paragrafi (1) i K(P)PK me përjashtim të shpenzimeve për përkthyes dhe përkthime. Një Aktvendim i veçantë për shumën e shpenzimeve do të merret nga Gjykata kur të merret të dhënat e tilla sipas Nenit 100 Paragrafi (2) i K(P)PK.

ARSYETIMI

I.

Gjykata e Qarkut në Mitrovicë është kompetente të dëgjojë këtë lende, Neni 23 pika 1) i) dhe Neni 27 paragrafi (1) i K(P)PK.

Gjyqtari i EULEX-it e caktuar në këtë lende në bazë të vendimit të Kryetarit të Asamblesë së Gjyqtareve të EULEX-it të datës 2 Gusht 2010, bazuar në Nenin 3.3 dhe 3.5 mbi Ligjin e Kompetencave, Seleksionimin dhe Caktimin e Lendeve të Gjyqtareve dhe Prokuroreve të EULEX-it.

II.

Gjykata është dashur të vendose për meritat e të dy akuzave edhe pse ajo e sheh akuzën e Vrasjes, kjo akuzë është tërhequr nga ana e Prokurorit Publik sepse Palët e Dëmtuara kanë vazhduar me ndjekje penale në lidhje me këto akuzë.

1.

Gjykata e kupton propozimin e Prokurorit Publik në fjalën e tij përfundimtare për të shpallur të Akuzuarin “Jo fajtor” në lidhje me akuzën e Vrasjes si tërheqje të kësaj akuzë. Neni 379 i K(P)PK përcakton në detale nevojën dhe përmbajtjen e mundshme të fjalës përfundimtare të Prokurorit Publik pa e cekur mundësinë e shfajësimit. Edhe pse nuk thuhet në mënyrë eksplicite se Prokurori Publik nuk guxon të propozojë Gjykatës shfajësimin, kjo rrjedhë nga sistemi i këtij Kodi. Kodi obligon Prokurorin Publik në të gjitha fazat e mëparshme të bëjë ndërprerjen e procedurës kurdo herë që heton se faktet nuk janë të mjaftueshme në përkrahjen e nivelit përkatës të dyshimit, Neni 208 paragrafi 1 pika 1 dhe Neni 224 paragrafi 1 pika 1 e K(P)PK.

Edhe pas ngritjes së Aktakuzës, Prokurori Publik gëzon të drejtën e tërheqjes nga ndjekja penale deri në përfundim të Gjyimit Kryesor të shkallës së Parë, Neni 52 K(P)PK. Logjikisht, ai duhet të bëjë këtë kur e sheh se dëshmia e paraqitur në Gjykimin Kryesor është e pamjaftueshme për dënim.

Nëse do të kishte Prokurori zgjedhje të propozojë shfajësim në vend të kësaj, e drejta e palës së dëmtuar të marrë përsipër ndjekjen penale pas tërheqjes nga akuzat do të nënvlerësohej. Kjo gjithashtu do të ishte e dëmshme për të Akuzuarin sepse në rastin e tërheqjes Gjykata duhet të refuzonte akuzën, Neni 389 pika 1 e K(P)PK gjersa Gjykata, përveç propozimit shfajësues do të mund të shpallte fajtor të akuzuarin.

Argumenti i Aktgjyimit material që çekë se nuk është vërtetuar mbi dyshimin e arsyeshëm se ai ka kryer veprën e pretenduar penale do të ishte më i favorshëm për të Akuzuarin se sa Aktgjykimi formal që do të thoshte se është hequr dorë nga ndjekja e

mëtutjeshme penale ¹ nuk është bindëse. Sa i përket pasojave ligjore nuk ka fare diferenca. Ky argument qarte nuk është miratuar nga gjyqësia vendore sepse praktika mbizotëruese vendore është të tërhiqet akuza kur dëshmia ne Gjykimin Kryesor konsiderohet e pamjaftueshme.

Prokurori Publik ne detale e ka elaboruar atë dhe ai e ka pare dëshminë si te pamjaftueshme për te vërtetuar akuzën dhe qarte e ka shprehur vullnetin e tij te mos vazhdimet me ndjekjen penale ne lidhje me akuzën e vrasjes. Prandaj Gjykata ka mundur dhe ka qene e detyruar te interpretoje propozimin e tij si tërheqje te akuzës.

2.

Gjykata nuk ka qene as e obliguar e madje as e autorizuar te refuzoje akuzën e Vrasjes si pasoje e tërheqjes se kësaj akuze nga Prokurori Publik.

Neni 389 pika 1 K(P)PK përcakton se Gjykata duhet te marre Aktgjykim refuzues te Akuzës nëse Prokurori e tërheqë Akuzën gjate periudhës nga hapja deri ne përfundim te Gjykimit Kryesor . Mirëpo kjo dispozite nuk është aplikuar sepse palët e dëmtuara kane vazhduar me ndjekjen penale. Është logjike se akuza nuk mund te refuzohet dhe te vlerësohet sipas meritave ne te njëjtën kohe. Kjo vërtetohet me Nenin 63 paragrafin 2 te K(P)PK i cili parasheh se Aktgjykimi qe refuzon tërheqjen e akuzës duhet te pezullohet nëse pala e dëmtuar nuk ka qene e pranishme ne Gjykimin Kryesor dhe duhet te aprovohet kthimi ne *status quo ante*. Ne lenden aktuale palët kane qene te pranishme-siq është kërkuar nga Neni 63, paragrafi 1 i K(P)PK – menjëherë kane deklaruar vullnetin e tyre për te vazhduar me ndjekjen penale. Prandaj, Gjykata ka qene e obliguar te vazhdoje menjëherë me Gjykimin Kryesor edhe sa i përket akuzës se Vrasjes meqë pala e dëmtuar si prokurore duhet te marre përsipër procedurën qe është ne vijim e sipër².

¹ Momcilo Grubac dhe Tihomir Vasiljevic, Komentim mbi Ligjin e Procedurës Penale (te RSFJ) 1999, Neni 340 shënimi 4:

Ne kundërshtim Branko Petric, Komentim mbi Ligjin e Procedurës Penale (te RSFJ) 1988, Neni 340 shënimi II.2 qarte konsideron tërheqjen e akuzës si te vetmen mundësi kur Prokurori heton se dëshmia është e pamjaftueshme.

² Branko Petric Komenti mbi Ligjin e Procedurës Penale (te RSFJ) 1988, Neni 61, shënimi I.1 dhe I.4.

Shënim: Neni 61 i RSFJ është identik me Nenin 63 paragrafi 1 i K(P)PK..

3.

Deklarimi për te vazhduar me ndjekjen penale i bere nga Asllan Fazliu, vëllai i viktimës se ndjere Ramadan Fazliu, si përfaqësues i palës se dëmtuar dhe veprimet e tij te mëtutjeshme si Prokuror Subsidiar janë te vlefshme. Se a mundet vëllai i viktimës se ndjere te veproje si pale e dëmtuar ne procedurën penale nuk mund te konkludohet nga definimi ligjor ne nenin 151 te pika 5 e K(P)PK qe thotë se “pala e dëmtuar” do te thotë personi te cilit u janë shkelur te drejtat personale dhe pronësore apo te cilit u janë rrezikuar nga vepra penale. Mirëpo, Neni 57 dhe Neni 62 paragrafi 6 i K(P)PK përcaktojnë personat qe munde te vazhdojnë me ndjekjen penale nëse pala e dëmtuar vdesë pas (dhe pavarësisht nga) kryerja e veprës penale ne fjale, duke përfshire vëllezërit dhe motrat. Ky përcaktim i personave te autorizuar për te ushtruar te drejtën e palës se dëmtuar pas vdekjes se tij/saj duhet te aplikohet ne analogji sepse interesi i anëtareve te familjes te palës se dëmtuar te ndjere për te marre pjese ne procedurën penale dhe/apo për te vazhduar me ndjekjen penale arsyetohet madje edhe me shume kur vdekja e palës se dëmtuar është shkaktuar nga vepra penale ne fjale. Prandaj, Gjykata i ka pranuar si pale te dëmtuar dy djemtë e te ndjerit Ramadan Fazliu, Ali dhe Arben Fazliu, si dhe dy vëllezërit Asllan dhe Istref Fazliu.


Gjykata nuk e ka caktuar përfaqësuesin e autorizuar *ex officio* për palët e dëmtuara sepse palët e dëmtuara nuk kane qene “veçanërisht te pambrojtur dhe ne nevoje substanciale për asistencë te përfaqësuesit te autorizuar” siç është kërkuar me nenin 82 paragrafi 1 nen-paragrafi 5, paragrafi 2 i KPPK. Asllan Fazliu, i cili ka vepruar edhe ne emër te palëve te dëmtuara është shume i shkolluar dhe Imam shume shprehës dhe ai ka qene ne gjendje te ushtrroje te drejtat e tij te palës se dëmtuar dhe ne funksion te prokurorit subsidiar pa asistencën e avokatit si përfaqësues i autorizuar. Kushtet tjera alternative te listuara ne Nenin 82 paragrafi 1 i K(P)PK (pala e dëmtuar është fëmije, ka marrëdhënje familjare me te pandehurin apo ka çrregullim mendor apo akuza ka lidhje me vepër penale seksuale apo trafikim te qenieve njerëzore) qarte nuk janë përmbushur.

III.

1.

Gjate procedurës dëshmuese janë marre me sa vijon:

Si dëshmitare janë dëgjuar



- (1) Dëshmitari (dhe Pala e Dëmtuar) Ali Fazliu,
- (2) Dëshmitari Ismet Istrefi
- (3) Dëshmitari Ekspert Dr. Enver Asllani.

Dokumentet ne vijim janë lexuar dhe kane hyre ne dëshmi:

- (4) Raporti Policor për obduksion, i datës 17 Dhjetor 2008 (f. 56 - 61),
- (5) Raporti i Obduksionit MA08-295, i datës 17 Dhjetor 2008 (f. 64 – 86),
- (6) Raporti i Ekzaminimit nga Forensika (Balistik), i datës 30 Janar 2009 (f. 93 - 99),
- (7) Raporti i Ekzaminimit nga Forensika (ADN), i datës 24 Mars 2009, (f.110 – 114),
- (8) Raporti i Ekspertizës (Mbetjet e Barutit), i datës 15 Prill 2009, (f. 115 – 120),
- (9) Format e Analizave te Ekspertit (f.130 – 158),
- (10) Albumi Fotografik Policor (Vendi i Ngjarjes, i Dyshuari, Arma), (f.178 – 197),
- (11) Raporti i Oficerit te Policisë, Rafet Boshnjaku i datës 16 Dhjetor 2008, (f.198 – 201),
- (12) Raporti i Oficerit te Policisë, Nysret Hasani i dates16 Dhjetor 2008, (202-203),
- (13) Raporti i Vendit te Ngjarjes i datës 16 Dhjetor 2008, (215 - 217),
- (14) Koleksioni i fotografive ne lidhje me vendin e ngjarjes/armës (f.220 – 223),
- (15) Lista e armës se gjetur e datës 18 Dhjetor 2008, (f. 228),
- (16) Fotografitë e Obduksionit te datës 17 Dhjetor 2008 (f. 231 – 248),
- (17) Raportet Mjekësore mbi te Akuzuarin , data te ndryshme 2000-2006, (f. 249 – 264),

Dokumenti ne vijim është hetuar se është i lexuar vetëm pjesërisht dhe ka hyre ne dëshmi nga dëshmia e dëshmitarit ekspert Dr. Enver Asllani:

- (18) Raporti Mjekësor i Dr. Enver Asllani datës 16 Dhjetor 2008.

(19) I akuzuari e ka dhënë deklaratën dhe iu është përgjigjur pyetjeve gjate shqyrtimit kryesor me 13 Dhjetor 2010.

2.

Arsyetimi nuk i referohet dëshmisë (4), (8) , (9), (12), (14), (15) dhe (17), sepse Gjykata është e mendimit se ato nuk kane ndonjë vlere shtese dëshmuese dhe asnjëra nga palët nuk iu është referuar asnjërës nga këto pjese te dëshmisë ne mënyre specifike.

IV.

Gjykata e ka shpallur te Akuzuarin fajtor për vrasjen e kryer qe e ka tejkeluar vete mbrojtjen e domosdoshme, Neni 146 siç lexohet me Nenin 8 te K(P)PK.

Neni 146 i K(P)PK përcakton se “kushdo qe e privon ndonjë person tjetër nga jeta e tij/saj” dënohet për vrasje. Sipas Nenit **8 paragrafi 1** i K(P)PK vepra e kryer ne vetëmbrojtje te domosdoshme nuk është vepre penale(paragrafi 1) Vepra e kryer ne vetëmbrojtje te domosdoshme, kur personi e kryen veprën me qellim qe te mënjanoje sulmin e paligjshëm, real dhe eminent ndaj tij/saj apo ndonjë personi tjetër dhe natyra e veprës është proporcionale me nivelin e rrezikut te paraqitur nga sulmi (paragrafi 2). Nëse plotësohen këto kushte paligjshmëria e veprës se kryer përjashtohet. Nëse vepra është jo proporcionale me nivelin e rrezikut te paraqitur nga vepra, vepra e tejkalon vetëmbrojtjen e domosdoshme (paragrafi 3) dhe ajo mbetet vepër penale.

1.

I Akuzuari i ka plotësuar elementet e veprës penale te vrasjes siç është përcaktuar ne Nenin 146 te K(P)PK sepse ai me qellim e ka privuar Ramadan Fazliun nga jeta e tij.

Gjykata ka vetëtuar se me 16 Dhjetor 2008 rreth orës 14:00 ne fushat te quajtur Çuka e Lisices te fshatit Rahove, rrethi i Mitrovicës i Akuzuari ka shtëne katër here nga pushka e tij automatike AK-47, te kalibrit 7.62x39mm me numrin serik C-97080 ne Ramadan Fazliun. Ramadan Fazliu është qëlluar dy here ne dorën e majte dhe dy here ne këmben e majte dhe ka vdekur disa minuta me vone nga palet e marra ne atë rast. Kur ka shtëne ne Ramadan Fazliun, i Akuzuari e ka ditur se te shtënat kane mundur ti shkaktojnë vdekjen Ramadan Fazliut dhe kështu ka ndodhur.

Gjer me tani Gjykata e ka vlerësuar dëshminë si vijon:

I Akuzuari ka pranuar ne deklaratën e tij te dhëne para Gjykatës se ai ka shtëne tri apo kater here ne Ramadan Fazliun me armen tij te lartpërmendur ne kohen dhe vendin e lartshënuar.

Vendi ku është gjetur Ramadan Fazliu qarte është përcaktuar ne albumin e fotove te policisë [shih III.(10)] nga koordinatat DN/819-535 dhe me emrin “Çuka e Lisices” Ne raport te krimin [shih III.13] ky vend është raportuar me te njëjtin emër. Vendi ku

Ramadan Fazliu është gjetur gjithashtu është vendi ku është shtëne ne te. Përndryshe do te kishte gjurme nga kjo – aktive apo pasive – lëvizje për shkak te gjakderdhjes se rende por sipas foto-albumit [III.(10)] nuk ka pasur gjurme te tille. I akuzuari ka folur rreth “Te Llazet” si vendi ku ka ndodhur incidenti por as ai e as Avokati i tij Mbrojtës nuk i kane sfiduar këto dokument asnjëherë. Gjykata ka konkluduar se i Akuzuari vetëm e ka përdorur te njëjtin emër për te njëjtën vend.

Raporti Policor ka vërtetuar se pushka automatike AK-47, 7.62x39 mm me numër serik C-97080 është marre nga i akuzuari me 16 Dhjetor 2008 [shih III.(11) dhe (13)] dhe katër gëzhgoja janë gjetur ne vendim e ngjarjen [shih+ III, (10)]. Nga ekzaminimi balistik [shih III.(6)] është vërtetuar se arma është funksionale dhe se gëzhgojat janë pjese te kalibrit 7.62x39 mm te cilat janë shtëne nga pushka automatike AK-47 te kalibrit 7.62x39 mm me numrin serik C-97080.


Raporti i Obduksionit [shih III.(5)] ka vërtetuar se Ramadan Fazliu është qëlluar katër here me fishekë, dy here ne dorën e majte dhe dy here ne këmben e majte te cilat kane shkaktuar shpërthimin e gjakut ne zonën e epërme te bërrylit dhe ne pjesën e epërme te kofshës e qe ka sjelle vdekjen e tij brenda disa minutave.

Nuk është paraqitur asnjë dëshmi kontradiktore për faktet e përcaktuara me lart nga asnjëra nga palët dhe Gjykata nuk ka pasur asnjë arsye te marre dëshmi te mëtutjeshme *ex officio*.

Se a ka qene i Akuzuari ne dijeni qe te shtënat kane mundur te shkaktojnë vdekjen e Ramadan Fazliu dhe kjo edhe ka ndodhur është për tu konkluduar nga rrethanat. Është njohuri e zakonshme se vurja ne shënjestër dhe gjuajtja me arme ne person me AK-47 ka gjasa te mëdha te shkaktoje lëndime fatale atij, veqanersht kur është shtëne disa here. I akuzuari i cili e ka mbajtur armen e tij qe nga lufta sigurisht se e ka ditur qe duke shtëne katër here ne Ramadan Fazliun ai e ka bere te mundshme vdekjen e te fundit edhe pse ai ndoshta nuk e ka dëshiruar atë.

Prandaj ai ka vepruar me te ashtuqajturin qellim indirekt siç definohet ne Nenin 15 K(P)PK qe është e mjaftueshme për pergjegjesine penale për kryerjen e qëllimshme te veprës penale.

2.



I akuzuari ka shtënë ne Ramadan Fazliun me qellim qe te mënjanoje sulmin e paligjshëm, real dhe eminent nga ky fundit.

Gjykata ka vërtetuar se gjate fazës se mosmarrëveshjes verbale ndërmjet te Akuzuarit dhe Ramadan Fazliut rreth kullotjes se bagëtisë ne zone Ramadan Fazliu qëllimisht e ka qëlluar te Akuzuarin nga mbrapa me gërshëre bujqësor dhe atij i ka shkaktuar nje plage te hapur ne anën a majte te nofullës menjëherë pasi i Akuzuari është kthyer mbrapa. Ne momentin e fundit. Ramadan Fazliu prap i ka ngritur duart lart me gërshëre bujqësore ne dore për te qëlluar te Akuzuarin i cili ka qene përballe tij ne atë kohe, herën e dyte. Ne atë moment i Akuzuari ka filluar te shtije ne Ramadan Fazliun ne mënyre qe te preventoje Ramadan Fazliun për ta goditur atë prapë me gërshëre bujqësor.

Gjer me tani Gjykata e ka vlerësuar dëshminë me sa vijon.

a) Gjykata është e bindur se mosmarrëveshja për kullotjen e bagëtisë ne zone ka vazhduar dhe eventualisht ka shkaktuar incidentin. I akuzuari ne deklaratën e tij te dhene Gjykatës ka pranuar se dy vite para incidentit ai e ka pastruar dhe rrethuar një hektarë toke te marre me qira nga kushëriri i tij ne mënyre qe te kullose bagëtinë ne atë vend. Disa here para incidentit ai e ka gjetur rrethojën te dëmtuar dhe disa here ai e ka gjetur brenda bagëtinë e Ramadan Fazliut. Ne ditën e incidentit ai vetëm ka qene ne zone dhe është ankuar te Ramadan Fazliu rreth kësaj heshtjeje kur ky i fundit ka ardhur ne ate vend. Ramadan Fazliu ka refuzuar dhe e ka quajtur atë gënjeshtar dhe ka pyetur qe atij ti tregohet dëmtimi.

Dëshmitari Ali Fazliu ka dëshmuar se babai i tij nuk ka pasur me pare ndonjë problem me te akuzuarin. Vetëm natën pas incidentit Ismet Istrefi i ka treguar atij se ai është kërcënuar me pare nga i Akuzuari dhe dy persona tjerë qe mos ti kullose bagëtinë e tij ne atë zone dhe se ai “gati është vrare”.

Mirëpo, dëshmitari Ismet Istrefi vetëm e ka vërtetuar se i Akuzuari dhe dy personat tjerë i ka thënë atij qe mos ti kullose bagëtinë ne atë zone dhe ti tregoje atë edhe Ramadan Fazliut.

Ai është pajtuar dhe e ka percjellur porosinë Ramadan Fazliut.

Gjykata nuk munde te përcaktoje se a e ka ekzagjeruar Ismet Istrefi, i cili e ka dhënë këtë dëshmi me shume ngurrim, kur ka folur me Ali Fazliun menjëherë pas vrasjes se

Ramadan Fazliut apo ai ka dashur te zbusë qeshtjen kur ka dëshmuar apo kujtesa e Ali Fazliut nuk është mjaft e sakte ne lidhje me atë se çka i kishte thënë Ismet Istrefi. Mirëpo, deri ne atë mase deklaratat e Ali Fazliut dhe Ismet Istrefi pajtohen; Gjykata i pranon ato si te besueshme dhe hedhe poshtë pretendimin e te Akuzuarit se ai do te kishte ngritur qeshtjen ne drejtim te Ramadan Fazliut herën e pare ne ditën e incidentit.

Kështu qe mosmarrëveshja verbale ndërmjet te te Akuzuarit dhe Ramadan Fazliut ne ditën e incidentit mund te ketë qene me i nxehte se sa është përshkruar nga i Akuzuari. Mirëpo, nuk ka dëshmi dhe as qe ka shenja te ndonjë akti te dhunshëm ndërmjet te Akuzuarit dhe Ramadan Fazliut, përveç goditjes me gërshëre bujqësor dhe te shtënës me arme. Nga raporti i obduksionit [III.(5)] është vetëtuar se Ramadan Fazliu nuk ka pasur lëndime tjera përveç lëndimeve nga te shtënat.

b) Gjykata është edhe me e bindur se Ramadan Fazliu e ka goditur te Akuzuarin me gërshëre bujqësor dhe kështu i ka shkaktuar atij varre te hapur ne pjesën e majte te nofullës.

I akuzuari ka thënë se ata kane ecur bashke për te pare dëmtimin e gardhit. Ramadan Fazliu i ka mbajtur gersheret bujqësor me vete dhe i Akuzuari e ka pasur me vete AK-47. Ramadan Fazliu ka ecur dy hapa prapa te Akuzuarit i cili pernjehere e ka vërejtur Ramadan Fazliun duke i ngritur duart e tij me gërshëre bujqësore për te goditur te Akuzuarin nga prapa. Kështu qe i akuzuari është kthyer prapa, ai nuk është qëlluar ne qafe por ne nofullën e majte. Sigurisht se i akuzuari ne përgjithësi eshte i interesuar te shfajesoje veten nga ndonjë fajësi. Mirëpo, Gjykata pranon deklaratën e te Akuzuarit si te besueshme sepse ajo përputhet me dëshmi objektive.

Dëshmitari Ali Fazliu ka vërtetuar se babai i tij i kishte pasur gersheret bujqësor me dorëz afro një metër te gjate, si sopat, dhe nganjëherë ai e ka mbajtur atë për tëharrje dhe prere te degëve. Një Gërshëre e tille është gjetur se bashku me trupin e Ramadan Fazliut ne anën e djathte te tij nen trupin e tij [shih III, (10) fotot 2-6, 9 dhe 13)].

Dëshmitari ekspert Dr. Enver Asllani ka deklaruar se ai e ka trajtuar te Akuzuarin me 16 Dhjetor 2008 ne ora 18.14 ne Spitalin e Mitrovicës dhe ai e ka lëshuar raportin mjekësor mbi te Akuzuarin, te datuar 16 Dhjetor[III.(18)] . Ai ka sqaruar se e vërteton varrën e

shkaktuar nga një objekt ne anën e majte te nofullës qe ishte qepu, atij iu ishin dhëne tableta antibiotike dhe paracetamol për te trajtuar varrën. Lëndimi ishte i natyrës se lehte sipas përshtypjes se pare. Dëshmitari ekspert me tutje ka thënë se i kujtohet qe ka qene lëndim i freskët dhe varre e hapur. Ka qene një lëndim i lehte sepse ishte nofulla dhe se nuk ka pasur vena te cilat munde te rrezikojnë jetën, derisa arteriet kryesore janë ne qafe.

Korrektësia e deklaratës se tij nuk vihet ne pyetje sepse ai ka një eksperience te gjate profesionale dhe nuk ka ndonjë interes personal ne lidhje me rezultatin përfundimtar te këtyre procedurave.

Varra e përshkruar nga dëshmitari ekspert përshtatet shume mire me versionin e te Akuzuarit. Prokurori Subsidiar ka argumentuar ne fjalën e tij te gjate përfundimtare se kur pjesa e mprehte e gershereve bujqësor është kthyer ne anën e brendshme, e duke u goditur nga mbrapa ne qafe i Akuzuari do te kishte marre vetëm “gërvishte” por ana e mprehte do te kishte hyre dhe dale ne kraharorë; poqe se do te ishte goditur nga ana frontale ana e mprehte do te përfundonte ne pjese tjetër te trupit. Ky argument injoron atë se i Akuzuari sipas deklaratës se tij nuk ka qene ne pozite statike por duke u kthyer mbrapa e qe është reagim normal kur personi e heton rrezikun potencial nga mbrapa. Nëse i Akuzuari nuk do te kishte lëvizur, goditja nga Ramadan Fazliu duke ecur djathtas mbrapa tij ne te vërtete do te kishte goditur te Akuzuarin ne anën e tij te djathte. Poqe se do te ishte kthyer mbrapa, ai logjikisht do te ishte goditur ne anën e majte. Përmasa dhe forma e pjesës se mprehte e gershereve bujqësore qarte mund te shihet ne dy fotografitë e Albumit Fotografik Policor [III.(10) p. 196]. Edhe pse pjesa e mprehte është kthyer nga brendësia dhe lakuar, ajo munde te shkaktoje varrën siç përshkruhet nga dëshmitari ekspert (pas qepjes) ne fotografinë 31 ne Albumin Fotografik Policor [III.(10) p. 196] dmth prerje gati horizontale prej disa centimetrash gjatësie ne nofullën e majte. Gjykata gjithashtu përjashton mundësinë e shqyrtuar nga Prokurori Subsidiar ne fjalën e tij përfundimtare se i Akuzuari ka mundur te shkaktoje varrën vetes. Gjykata është e bindur se i Akuzuari me një shkollim thelbësor nuk do te ishte ne gjendje te trillonte një tregim konsekuent qe do te përshtatej saktësisht me lëndimin e tij apo te shkaktonte vetes një lëndim qe saktësisht do te përshtatej me rrethanat e dhëna.

Ekspertiza e ADN-se [III.(7)] nuk ka ofruar prova tjera sepse ajo vetëm konkludon se mostrat e gjakut të marra nga vendi i ngjarjes dhe mostrat e gjakut të marra nga gersheret bujqësore i takojnë të njëjtit person mashkull. Mirëpo, asnjëra nga palët nuk ka kërkuar marrjen e dëshmisë së mëtutjeshme në lidhje me gjurmet e ADN-se dhe Gjykata e nuk ka parë të domosdoshme që të merret dëshmia *ex officio* sepse edhe poqë se nuk mund të identifikohet gjaku i Akuzuarit në pjesën e mprehte të gershereve bujqësor ajo nuk vërteton se ai nuk do të prehej, veçanërisht nisur nga sasia e madhe e gjakut nga lëndimet e Ramadan Fazliut e që kanë mundur të mbulonin gjurmët tjera.

c) Gjykata nuk ka dyshim se Ramadan Fazliu e ka goditur të Akuzuarin me gërshërë bujqësore para se i Akuzuari të shtie në atë dhe jo anasjelltas. Ramadan Fazliu është qëlluar në dorën e tij e pastaj është lënduar rëndë nga fillaku i parë i shtëne nga i Akuzuari. Kështu që ai nuk do të ishte në gjendje të ngriste gersheret bujqësore dhe të godiste të Akuzuarin me ato, në reagim me të shtëna. Me tutje, nëse i Akuzuari ka pasur qellim të shtie në Ramadan Fazliun pa ndonjë sulm të mëparshëm nga ky i fundit, ai sigurisht se do të kishte shtëne nga një distance e sigurtë në vend që të lejonte Ramadan Fazliun të afrohej aq afër për të qëlluar të Akuzuarin me gërshërë bujqësor.

d) Gjykata është edhe më e bindur se Ramadan Fazliu prapë i ka ngritur duart e tij me gërshërë bujqësore me qellim që të qëllonte të Akuzuarin për të dytën herë, i cili në atë kohë ka qenë përballë tij. I Akuzuari ka thënë se pasi që është goditur me gërshërë bujqësore ai ka lëvizur dy hapa mbrapa dhe e ka pyetur “perse mundohesh të më vrasësh?”. Ramadan Fazliu është përgjigjur “Tani do të tregojë” dhe prapë i ka ngritur duart duke mbajtur gërshërë bujqësore. Në atë moment i Akuzuari ka hapur pushken e tij dhe ka shtëne në Ramadan Fazliun të cilin e kishte përballë nga një distance që beson se ishte jo më pak se dy metra. Gjykata e pranon këtë deklaratë si të besueshme veçanërisht në lidhje me tentimin e Ramadan Fazliut të godisë të Akuzuarin herën e dytë me gërshërë bujqësore. Raporti i Obduksionit [III.(5)] dhe fotografitë 33 – 37 e Fotografive të Obduksionit [III.(16)] vërtetojnë se drejtimi i të shtënave në pozitën normale të trupit në këmbë të viktimës kanë qenë nga e majta dhe mbrapa në të djathtë dhe përpara. Mund të shihet qartë se dy fishekët kanë hyre në pjesën e prapme të epërme të dorës së majte të Ramadan Fazliut. Kjo përputhet saktësisht me situatën e përshtetur nga i Akuzuari, dmth se Ramadan Fazliu i ka ngritur të dy duart e tij duke i mbajtur gërshëret bujqësore. Në atë pozite ana e prapme e pjesës së epërme të dorës së Ramadan Fazliut

është kthyer ne drejtim te Akuzuarit i cili ne atë kohe ka qene përballë tij. Me tutje, është shume e besueshme se Ramadan Fazliu ka pasur qellim te qëllonte te Akuzuarin për here te dyte me gërshëre bujqësore sepse i Akuzuari ka marre vetëm lëndime te lehta nga goditja e pare dhe ai e ka pasur ne dore AK-47-in e tij.

e) Prandaj, tentimi i Ramadan Fazliut qe te godasë te Akuzuarin për here te dyte me gërshëre bujqësore ka qene sulm i kundërligjshëm, real dhe eminent kundër te Akuzuarit dhe i Akuzuari ka pasur te drejte te reagoje ne vetëmbrojtje te domosdoshme.

3.

Trupi Gjykses ka vendosur qe i Akuzuari i ka tejkualuar nivelet e vetëmbrojtjes se domosdoshme sepse katër fishekët e shkrepur ne Ramadan Fazliun ka qene jo proporcionale me shkallen e rrezikut nga sulmi i Ramadan Fazliut.

Tentimi i Ramadan Fazliut për te qëlluar te Akuzuarin herën e dyte me gërshëre bujqësore e ka rrezikuar jetën e te Akuzuarit edhe pse goditja e pare ka shkaktuar vetëm lëndime te lehta trupore. Kjo rrjedhe nga deklarata bindëse e dëshmitarit ekspert Dr. Enver Asllani se kjo ka qene vetëm për shkak te vendit te varrës ne nofullën e majte derisa do te ishte ndryshe nëse arteriet kryesore ne qafe do te ishin goditur. Është njohuri normale se prerja e arterieve kryesore shkakton gjakderdhje fatale brenda nje kohe shume te shkurtër. Me tutje, Ramadan Fazliu ka qene rreth pesëmbëdhjete vite me i ri dhe shume me i forte [shih III. (10) fotografitë 2-11]] se sa i Akuzuari. Askush tjetër nuk ka qene përreth e qe do te mund te preventonte sulme tjera.

Nisur nga këto rrethana i Akuzuari nuk ka pasur mjete me pak te dëmshme qe te mënjanonte sulmin se sa te gjuante me armen e tij. Mirëpo, vetëm e shtëna ne ajër nuk do te ishte e mjaftuar sepse distanca ndërmjet Ramadan Fazliut dhe te Akuzuarit ka qene rreth dy metra. Kështu qe, Ramadan Fazliu ka mundur qe te jete ne gjendje te munde te Akuzuarin dhe te ia merrte armen atij.

Prandaj i Akuzuari nuk e ka tejkualuar vetëmbrojtjen e domosdoshme nga e shtëna e pare ne Ramadan Fazliu.

Mirëpo, Trupi Gjykses ka vendosur se e shtëna e pare e tij ka qene e mjaftuar te mënjanonte sulmin eminent sepse ajo e ka qëlluar pjese e epërme te dorës se Ramadan Fazliut dhe me ketë lëndim Ramadan Fazliu nuk do te ishte ne gjendje te vazhdonte me sulm.

Gjykata e pranon se nuk munde te përjashtohet se Ramadan Fazliu ka mundur te vdiste nga lëndimet te shkaktuara atij nga e shtëna e pare, nëse i Akuzuari nuk do te kishte vazhduar me te shtena. Raporti i Obduksionit [III. (5)] vetëm përcakton se vdekja e Ramadan Fazliut ka qene e shkaktuar nga shpërthimet e gjakut ne zonën e bërrylit te majte dhe ne pjesën e epërme te majte. Mirëpo, Trupi Gjykues ka vendosur se ne lidhje me te gjetjen e asaj se a e ka tejkalar i Akuzuari vetëmbrojtjen e domosdoshme, shkrepja e katër te shtënave do te konsiderohej si një akt pa kurrfarë dallimi sa i përket pasojave.

Kështu qe i Akuzuari është dashur te shpallet fajtor për vrasjen e Ramadan Fazliut.

V.

Dënimi për veprën penale te vrasjes lihet anash.

Vepra penale e Vrasjes dënohet me burgim prej se paku pese viteve, Neni 146 i K(P)PK. Mirëpo, kur kryesi i veprës penale tejkalon nivelin e vetëmbrojtjes se nevojshme dënimi munde te zbritet dhe nëse kryesi i veprës i tejkalon nivelet per arsye te traumave te renda apo frikës se shkaktuar nga sulmi dënimi munde te lihet anash, Neni 8, paragrafi 4 i K(P)PK.

Gjykata është e bindur se i Akuzuari ka vepruar nga frika e madhe e shkaktuar nga sulmi kur ai ka vazhduar te shtie ne Ramadan Fazliun pas te shtënës se pare.

Se i akuzuari ka vepruar nga frika kjo rrjedhe nga rrethanat. Incidenti ka ndodhur ne nje vende te largët ku i Akuzuari ka qene vetëm me kundërshtarin e tij shume me te ri dhe shume me te forte, i cili e kishte goditur atë me gërshëre bujqësore dhe qe është munduar ta godasë atë prapë dhe i cili ka qene një distance prej afro dy metrave larg tij. Ramadan Fazliu është lënduar nga e shtëna e pare por derisa ai ende lëvizte i Akuzuari nuk ka mundur te ishte i sigurte se Ramadan Fazliu nuk do te ishte ne gjendje te vazhdonte me sulmin ndaj tij.

Nuk ka nevojje te përcaktohet se a ka vepruar ai për shkak te traumave.

Gjykata ka vendosur te le anash dënimin duke marre ne konsiderate se i Akuzuari është një person i vjetër pa ndonjë dënim te mëparshëm i cili është dorëzuar policisë menjëherë pas incidentit dhe i cili ka qëndruar afro dy vite ne paraburgim si pasoje e këtij incidentit.

Qëllimet e dënimit janë shënuar në Nenin 34 të K(P)PK, për të;

- Preventuar kryesin e veprës për të kryer vepra penale në të ardhmen.
- Të rehabilitojë kryesin e veprës dhe të frenojë personat tjerë nga kryerja e veprave penale

Asnjëra nga këto qëllime nuk kërkojnë shqiptim të dënimit ndaj të Akuzuarit në këtë rast.

VI.

1. I akuzuari Asllan Geci është deklaruar i fajshëm për akuzat të mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nën nenin 328 paragrafi 2 të Kodit Penal të Kosovës.

Gjykata është e pëlqimit se dëshmitë e mbledhura në dosje të lëndës plotësisht mbështesin akuzat dhe deklarin e dhënë nga i Akuzuari

2. Gjykata e gjene dënimin e burgimit me dy vjet si të duhur rreth vuajtjes së qëllimit të dënimit nën nenin 34 të KPK-së. Dënimi i aplikueshëm për posedim të paautorizuar të armëve nën nenin 328 paragrafi 2 përfshin dënimin me gjobe deri në 7500 Euro dhe vuajtje të burgimit prej 1 deri në 8 vjet. Një rang aq i gjere jo i zakonshëm i sanksioneve të mundshme i jep Gjykatës liri të madhe veprimi në vendim të rasteve individuale.

Gjykata konsideron si një qeshtëje të dispozitave të përgjithshme se frekuenca e krimeve të kryera me përdorimin e armëve në Kosovë, shpesh rezultojnë me vdekje apo lëndime serioze, prandaj është i nevojshëm sanksionimi i posedimit ilegal të armëve me burgim me afat kohor me shumte se zgjatja minimale. Gjykata është e përkushtuar që të dërgoj sinjal se nuk do të tolerohet posedimi i lehtë i armëve dhe burimi i tyre për tu përdorur si mjet i zgjidhjes së konflikteve pa ndëshkime.

Gjykata e morri si faktor rëndësues posedimin afatgjatë të armëve, domethënë pas luftës, pa autorizim valid. Gjykata e morri si faktor lehtësues që i akuzuari me i vjetër duke jetuar në një zonë të largët mbajti armën për vetëmbrojtje kundër sulmeve të mundshme nga njerëzit dhe kafshe të egra. Në vazhdim i Akuzuari nuk ka shënime penale paraprake dhe ka pranuar fajin lidhur me këtë veprë që nga fillimi i procedurës

VII.

Dënimi shtese rreth konfiskimit te armës është i obligueshëm konform nenit 60 (1) dhe nenit 328 (6) te KPK-se.

VIII.

Masa e arresti shtëpiak kundër te Akuzuarit ka qene e përcaktuar me efekt te menjëhershëm. I Akuzuari ka qene ne paraburgim për një vit dhe 10 muaj kështu qe kane mbetur për tu mbajtur vetëm dy muaj burg. Duke a pasur parasysh ketë kohe te shkurte dhe moshën e te Akuzuarit rreziku i ikjes, mbi te cilën me pare është bazuar paraburgimi nuk ekziston me.

Tara Khan
Procesmbajtëse

Christine Lindemann-Proetel
Kryetare e Trupit Gjykes

Keshille ligjore: Palët munde te paraqesin ankese me shkrim kundër këtij Aktgjykimi para Gjykatës Supreme te Kosovës përmes Gjykatës se Qarkut ne Prishtine brenda pesëmbëdhjete (15) ditëve nga data e marrjes se kopjes se Aktgjykimit sipas Nenit 398, Paragrafi 1 i K(P)PK

ZS- E-Alb

